

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
 MINISTRIJA ZA POLJOPRIVREDU I ŠUMARSTVA I
 RURALNOG RAZVOJA - MINISTRY OF AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT
 Kuvendi i Qendrës - Centralni Arhivë - Centralni Arhivë

Br./No. 3166
 3

Prilaziti/Prilaziti/Prilaziti
 5/09/2017

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
 KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUSHTRRI

02 No./Br. 1002/17
 No./No./Br. -03-
 Data/ Datum 04.09.2017

VUSHTRRI - VUCITEN

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva I
 Ruralnog Razvoja – Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

N.H. V.P., „IBËR-LEPENC” SH.A. D.D.
 01-2364 Dt. 13.09.2017
 PRISHTINË - PRISTINA



NH “IBËR - LEPENC” SH.A.
 HE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
 VP “IBËR - LEPENC” D.D.



KOMUNA E VUSHTRRISË
 OPŠTINA VUSHTRRI
 MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

MEMORANDUM BASHKËPUNUMI PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË ZGJERIMIT TË SISTEMIT TË UJITJES

I lidhur ndërmjet:

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; (MBPZHR),
2. Komuna e Vushtrrisë, dhe
3. NH „Ibër Lepenci” SH.A. (IL) – Prishtinë

Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të kontributit të dhëne në zhvillimin e bujqësisë, do të investojë në zbatimin e Projektit të zgjerimit të sistemit të ujitjes në fshatin Samadrexhë dhe Panitinë të Komunës së Vushtrrisë.

Palët janë pajtuar si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim zgjerimin e sistemit të ujitjes në fshatin Samadrexhë dhe Pantinë - Komuna e Vushtrrisë.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij memorandum të bashkëpunimit janë të obligueshme për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të përcaktuara për zgjerimin e sistemit të ujitjes, në koordinim të përbashkët me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komunën e Vushtrrisë, dhe NH „Ibër Lepenci” SH.A. (IL) – Prishtinë.

Neni 3

Obligimet e MBPZHR

1. MBPZHR, obligohet që të ndajë mjetet financiare dhe të mbuloi koston e tërësishme të riparimit të zgjerimit të sistemit të ujitjes në fshatin Samadrexhë – zgjerimin e rrjetit në Doberllukë, rregullimin e gypave të metalit në Pantinë, tek dalja e pompave dhe rregullimi i Pusetës në Stanoc.
2. Mjetet financiare të ndara nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen nga investimet kapitale të Kodit organizativ nr.40100 DPB&T të MBPZHR-së.
3. Mjetet financiare nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni MBPZHR-ja i barten operatorit Ekonomik të përzgjedhur nga Ministria në pajtim me kushtet e kontratës, si dhe raportet e menaxherit të kontratës që kryen pagesat në bazë të situacioneve.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna e Vushtrrisë obligohet që të krijojë kushtet e nevojshme për zbatimin e projektit nga neni 1 i këtij memorandum të bashkëpunimit.
2. Komuna merr për obligim evitimin e pengesave eventuale të natyrës juridiko-pronësore në tokat që gjenden në zgjerimin e sistemit të ujitjes.

Neni 5

Obligimet e NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL)

1. NH "Ibër Lepenci" SH.A. obligohet që të krijojë kushtet e nevojshme për zbatimin e projektit nga neni 1 i këtij memorandum të bashkëpunimit.
2. NH "Ibër Lepenci" SH.A. merr për obligim evitimin e pengesave eventuale të sistemit të ujitjes.
3. NH "Ibër Lepenci" SH.A mbas pranimit teknik të projektit merr për obligim menaxhimin e këtij zgjerimi të sistemit të ujitjes.

Neni 6

Komisioni për mbikëqyrjen (Menaxheri i Projektit)

1. Komisioni, formohet me Vendim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përbërje prej tre 3 anëtarësh nga Ministria, një anëtar nga Komuna dhe një anëtar nga NH "Ibër Lepenci".
2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij memorandum të bashkëpunimit bënë mbikëqyrjen e zbatimit dhe pranimit teknik të projektit të zgjerimit të sistemit të ujitjes, në bashkëpunim me kompaninë mbikëqyrëse.

Neni 7
Ndryshimet dhe plotësimet

1. Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese, memorandumi mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Pala e cila dëshiron ndryshimin – plotësimin e këtij memorandumi është e obliguar që në afat prej 30 ditësh, paraprakisht të paraqes kërkesën në formë të shkruar.
3. Në rast se konstatohet se Komuna e Vushtrrisë apo NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL) nuk i ërmbush obligimet e veta të dala nga ky memorandum, atëherë MBPZHR e mban të drejtën e ndërprerjes së mjeteve financiare të destinuar për zbatimin e këtij projekti.

Neni 8

Në rast të mos marrëveshjeve eventuale lidhur me aplikimin e dispozitave të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, palët do të tentojnë t'i zgjedhin me marrëveshje, nëse kjo nuk mund të arrihet, atëherë secila palë do ta këtë të drejtën e inicimit të procedurës adekuate në Gjykatën kompetente në Prishtinë.

Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është hartuar në dy (3) kopje identike, nga një për secilën palë kontraktuese.

Neni 10

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

PER: MBPZHR

Kapllan HALIMI

Sekretar i Përgjithshëm



PER: NH "Ibër Lepenci" SH.A

Enxhet Kabashi,

Kryeshf ekzekutiv



PER: Komuna e Vushtrrisë

Bajram MULAKU,

Kryetar i Komunës

